

FJALA E DEPUTETIT SALI BERISHA

E ENJTE 24 NËNTOR 2022

Të dashur qytetare dhe qytetarë që ndiqni këtë seancë,

Deputete dhe deputetë,

Zonja Kryetare,

Sot këtu diskutohet për plaçkitjen më të madhe në historinë kombëtare të një prone publike nga një grup i kryesuar nga Edi Rama, i cili kërkon të shndërrojë në pronë dhe pasuri personale pronën publike më të çmuar që kanë shqiptarët sot, portin e Durrësit. Në këtë akt të kësaj mega-afere të pashembullt kërkohet t'u kufizohet me çdo kusht fjala deputetëve të parlamentit.

Sigurisht që me marrëveshjen që votuat në vitin 2020, edhe atë me procedurë të përshpejtuar; marrëveshjen me Emiratet, me procedurë të përshpejtuar, në kundërshtim me Kushtetutën dhe detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë në Marrëveshjen e StabilizimAsociimit, ju i krijuat grupit të Edi Ramës të gjitha favoret, avantazhet dhe garancitë ligjore për këtë plaçkitje të tmerrshme e të pashembullt që ka ndodhur ndonjëherë në historinë e një vendi. Sot ju kërkoni të varrosni portin shekullor, mijërvjeçar të Durrësit si pronë publike të shqiptarëve dhe ta shndërroni këtë në pronë private të klanit "Rama" dhe të ndonjë arabi okazional, të ndonjë arabi, i cili u zotua për 4 miliardë euro investim buzë Danubit në Beograd dhe përfundoi me 20 milionë euro, të tjerat i morën "bratja Kariç".

Historia e kësaj vjedhjeje, e kësaj plaçke, është më e turpshme, më kriminalja! Klani "Rama", me 60% të aksioneve, kaq thuhet, që nuk tregohen (se çfarë ka Alabar-i dhe çfarë ka Rama në pjesën "Rama-Alabar", atë nuk do ta marrim vesh ndonjëherë), u përvetëson shqiptarëve 200 mijë metra katrorë tokë në pjesën më të kushtueshme të Durrësit! Ky klan u zhduk shqiptarëve portin e tyre mijërvjeçar, që ka qenë gjithnjë porta e hyrjes së Europës drejt Ballkanit dhe e Ballkanit drejt Europës! Ka qenë nyja kryesore e lidhjes me Kostandinopojën, porti që me Rrugën Egnatia lidhej me Kostandinopojën. Sot ky port asgjësohet me gjithë qindra e qindra milionë euro investime në këto 30 vjet dhe më parë në këtë port.

Kapaciteti i tij është aktualisht 8 milionë tonë mall përpunim dhe ka arritur në 4,8 milionë. Pozicioni i tij në shekuj dhe mijëvjeçarë është përcaktuar më i përshtatshmi për trojet arbnore. Për Durrësin dhe

qytetarët e tij ka qenë porti ku ata kanë siguruar kafshatën dhe jetesën, kanë mbijetuar në kohëra, pavarësisht nga çfarë kanë përjetuar. Sot klani "Rama" merr përsipër të përvetësojë 200 mijë metra katrorë, merr përsipër të ndërtojë me paratë në ajër; të gjitha, vetëkuptohet, para të pista, të zeza. A e keni marrë vesh ju tregtinë që bëhet me bitcoin-et, mashtrimin e madh që bëjnë call center-at nën patronazhin e Olsi Ramës? A e dini se ky është kuleta më e madhe e bitcoin-ave në Europë? A ju kujtohet një deklaratë e atij Çelës, që ju tha se pa energji po na lë bitcoin-i? A e dini ju me sa urgjencë erdhi këtu ligji i bitcoin-it? Pa pyesni pak: çfarë po ndodh me bitcoinin?

Deri tani, europiano-perëndimorëve u janë vjedhur nga Shqipëria 2,2 miliardë euro. Të gjitha kanë përfunduar në kuletat digjitale. Pse, çfarë kujtoni ju, se Amant Josifi do të mund ta zhvillonte këtë veprimtari me call center-in e tij po të mos kishte mbrojtjen politike të Edi Ramës? Kurrën e kurrës! Ato call center-at, që ndiqeshin për call-et që u bënë, duke i orientuar në bursë, janë në hetim të plotë, ndërsa këto që vjedhin bitcoin-et, këto nuk hetohen fare; kanë mbrojtje politike! 12600 apartamente, 900 njësi akomodimi hoteliere. Do të mblidhen këtu mumuthët e Shqipërisë dhe të Lindjes së Mesme, do të kenë edhe jahtet aty për karshi, kurse shqiptarët do të jenë popull gomonesh. Shqiptarët do të jenë ose shërbëtorë të tyre, ose do të largohen nëpër Europë.

A e dini ju sa kushton porti i ri, ekuivalent me portin e Durrësit? Kushton 2 miliardë euro. Nga do të dalin këto 2 miliardë euro? Nga taksapaguesit e mjerë dhe të varfër shqiptarë. Pra, këta këtu fitojnë 4-5 miliardë euro, shqiptarët paguajnë 2 miliardë euro për fitimet e tyre, për plaçkën që këta marrin. Thirrini arsyet në qoftë se keni, qoftë edhe 1 nanogram ndërgjegje shoqërore, ndërgjegje njerëzore, ndërgjegje kombëtare dhe hidheni poshtë këtë marrëveshje! Mos u përpiqni ta mbulonit duke shkurtuar kohën e diskutimeve! Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit është shkelur me të dyja këmbët: shkel Kushtetutën e Shqipërisë, pasuron Edi Ramën dhe klanin e tij! Marrëveshja është fund e krye një mashtrim ligjor, shpall kompani sigurimi kompaninë e ndërtimit në Dubai! Marrëveshja nuk respekton asnjë rregull, asnjë ligj.

Kjo përjashtohet nga çdo gjë dhe Edi Ramës i është dhënë çdo garanci, që asnjë qeveri të mos mund ta padisë mbrapa. Edi Rama, të jesh i bindur se te porti i marinës do të përfundosh vetë dhe nuk do të dalësh më kurrë prej tij! Nuk ka burg që të mban ty me këtë që po bën! Dhe ti, zonjë, që ke qejf t'i ndash deputetët në kategori të parë dhe të dytë, dije se kjo është histori turpi dhe vetëm turpi! Unë e kuptoj shumë mirë ndarjen e kohës dhe kjo është normale, por në qoftë se anëtarëve të grupeve parlamentare u takon një kohë e caktuar, ajo kohë duhet t'i jepet e barabartë çdo deputeti. Ti je e vetmja në botë që, nën urdhrat dhe si vasale e një njeriu të papërgjegjshëm, e ndan parlamentin në këtë mënyrë, por kjo do

të marrë fund. Ju garantoj që ky parlament nuk do të funksionojë dot asnjë ditë kështu siç e keni caktuar ju.